



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr. 320 - 34696/25
Klinë, me 15.10.2025

Projekti komunal për përkrahjen e fermerëve me Paisje Bujqësorë

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë, Komuna e Klinës respektivisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural publikon :

SHPALLJE PUBLIKE

Ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin komunal në përkrahjen me Paisje bujqësorë:

1. Freza për traktor 2 m
2. Freza për traktor 1.65 m
3. Spërkatëse 400 L
4. Motokultivator

Drejtoria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural me këtë projekt do të kontribuoj me 70 % ndërsa fermeri me 30 %.

Kriteret e konkurrit:

1. Fermeri duhet të jetë qytetar i komunës së Klinës
2. Të ketë sipërfaqe të tokës bujqësorë
3. Fermeri duhet të ketë traktor
4. Fermeri duhet të jetë i gatshëm të marrë pjesë me 30% të koston në paisje bujqësorë
5. Përparësi kanë fermerët të cilët në dy vitet e fundit nuk kanë përfituar ndonjë projekt bujqësorë nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën
6. Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtarë i bashkësisë familjare
7. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë Freza, Spërkatëse gruri dhe Motokultivator.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e shkruar nga vetë fermeri
2. Çertifikata e Pronësisë - Fleta Poseduese e Tokës
3. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
4. Çertifikata e fermeri me aneks (NIF-i) në emër të apikuesit
5. Çertifikata e vendbanimit
6. Çertifikata e bashkësisë familjare

Afati i aplikimit nga data 15.10.2025 deri me 29.10.2025

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën e arhivës komunale.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Vërejtje: Fermerët duhet të aplikojnë vetëm për njërin nga pajisjet bujqësorë

Drejtori i BPZHR

Lorenc Marleku

